



Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato Received/Delivety	30.12.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Printeg Appendix	Sasia Kohësina Quantity
SKDMSTHEK	6423/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.938/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, me Flakron Gashi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën numër A.Nr.938/2021 të datës 17.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rr."C", Alko Group, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër protokoli 751/03 të datës 19.10.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.12.2021, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.938/2021 e datës 17.11.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anullohet Vendimi me numër protokoli 751/03 i datës 19.10.2021, i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Mistrisë së Punëve të Brendshme që ankueses ti kompensoj diferencën e pagës prej 30%, të ndalur sipas Vendimit me numër protokoli 751/03 të datës 19.10.2021 të Komisionit Disiplinor.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil, që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga momenti i pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare për Regjistrim të Automjeteve" në Agjencinë për Regjistrim Civil, me datë 17.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër protokollit 751/03 të datës 19.10.2021 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shqiptimin e masës disiplinore "ndalim prej 30% të pagës për periudhën kohore katër (4) mujore".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 23.11.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 02.12.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokollit 5778/2021, se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës fq 1/25.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën ankueses të datës 17.11.2021 me numër protokollit 5490/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër 751/03 të datës 19.10.2021; E-mailin e datës 01.11.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen; E-mailin e datës 01.11.2021 dërguar nga [redacted] për E-mailin e datës 16.07.2021 dërguar nga [redacted] për E-mailin e datës 16.07.2019 dërguar nga ankuesja për me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; E-mailin e datës 25.02.2019 dërguar nga ankuesja për E-mailin e datës 26.10.2021 dërguar nga ankuesja për Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.11.2021; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.12.2021; ndryshimi i aktit të emërimit i ankueses i datës 06.06.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankueses; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 21.12.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 23.12.2019; Kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e datës 16.09.2021; Regjistrin elektronik të vijueshmërisë në punë për ankuesen nga data 09.08.2021 deri më datë 30.09.2021; E-mailin e datës 13.09.2021 dërguar nga [redacted] për dhe të tjerat lidhur me stafin esencial në ARC me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh; Deklaratën e ankueses të datës 14.09.2021; E-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga [redacted] për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 01.11.2021 dërguar nga [redacted] për dhe të tjerëve; Lista elektronike me ditët e pushimeve të shfrytëzuara nga ankuesja për vitin 2021; Vendimin Nr.01/32 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 28.08.2021; Vendimin Nr.01/32 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 28.08.2021; E-maili i datës 13.12.2021 dërguar nga Këshilli për Njësinë e Burimeve Njerëzore të MPB-së; E-maili i datës 13.12.2021 me numër protokollit:6024/2021 me provat e bashkangjitura shtesë si vijon: Listën e pagave për muajin shtator, tetor dhe nëntor 2021; Kontratën e datës 03.09.2021 të lidhur me Qendrën Edukative "Bardha" për qëndrim ditor të fëmijët, Ndalesën e 30% të pagës së ankueses për muajin nëntor 2021 si dhe përgatitjen për ndalën e 30% të pagës së ankueses për muajin dhjetor 2021, provat shtesë me numër protokollit 6301/2021 të datës 23.12.2021 nga f.1/8.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar së Udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses në pozitën e Drejtorit të Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve, me datë 24.09.2021 ka parashtruar kërkesë pranë Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (me tej MPB), për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses me pretendimin se e njëjta ka kryer shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuara me neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.5 dhe 3.6 të Ligjit Nr.06/L- 114 për Zyrtarët Publikë, duke shtuar me tutje se ankuesja ka munguar në punë me datë 30.08.2021, 02.09.2021 dhe 10.09.2021, ndërsa me datë 14.09.2021, ka bërë kërkesë për lirim nga puna duke u bazuar në Vendimin Nr.01/35 të datës 12.09.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe se nuk është lajmëruar në vendin e punës deri me datë 21.09.2021.

Komisioni Disiplinor i MPB-së, me datë 19.10.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 751/03, me të cilin ankuesen e ka shpallë përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3, nën paragrafi 3.5 dhe 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalim prej 30% të pagës për periudhën kohore katër (4) mujore*”, sipas nenit 47 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokollit 751/03 të datës 19.10.2021 të Komisionit Disiplinor, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi në fjalë është i pa bazuar në fakte dhe i njëjti është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, ka analizuar Vendimin me numër protokollit 751/03 të datës 19.10.2021 të Komisionit Disiplinor të MPB-së, dhe rrjedhimisht në kuptim të dispozitave të nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka vlerësuar së arsyetimi i vendimit është i pamjaftueshëm dhe i pa qartë, Komisioni Disiplinor fare nuk ka specifikuar ditët e mungesës në punë të ankueses si dhe nuk ka vlerësuar drejtë faktet të cilat kanë qenë relevante për vërtetimin e përgjegjësisë disiplinore të ankueses. Ndërlidhur me këtë konstatim, si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja përkitazi me mungesë e saj në punë me datë 30.08.2021, ka prezantuar kartelën e vaksinimit Pooo650064 sipas së cilës rezultoni e njëjta me datë 30.08.2021 ka marrë dozën e parë të vaksinës kundër Covid-19 në Istog dhe si rrjedhojë bazuar në praktikën institucionale, nëpunësve publikë ju është lejuar ditë pushimi dita e vaksinimit. Ndërsa, lidhur me mungesën në punë për datë 02 dhe 10 shtator 2021, Kolegji nga provat e lëndës të parashtruara nga ankuesja ka gjetur se e njëjta paraprakisht ka njoftuar Udhëheqësin e saj për

mungesën në punë duke qenë në pajtim me nenin 10 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Përkitazi me mungesën në punë të ankueses për përudhen nga data 14 deri 26 shtator 2021, Kolegji ju referua Vendimit Nr.01/35 të datës 12.09.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, sipas të cilit Vendim në pikën C numër 5 (mbrojtja dhe siguria në punë) është përcaktuar se: *“Në institucionet publike dhe private, deri me datë 26 shtator 2021 vazhdon obligimi që të paraqitet në punë vetëm stafi esencial, ndërsa stafi jo esencial obligohet të punojë nga shtëpia....”* kurse me pikën DH në numër 20 dhe 21 (institucionet e arsimit) është paraparë se: *“20 Aktiviteti mësimor në institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar, duke përfshirë edhe institucionet e arsimit parashkollor dhe të qëndrimit ditor pezullohet deri me datë 26 shtator 2021.... 21. Për familjet me fëmijë të regjistruar në institucione parashkollore dhe me dy prindër të punësuar (ose që ka vetëm një prind dhe ai prind është i punësuar), njëri prind lirohet nga obligimi për t'u paraqitur fizikisht në punë gjatë periudhës 13 - 26 shtator 2021. 2021”*. Ndërlidhur me këtë Vendim dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së në zbatim të Vendimit Nr.01/35 të datës 12.09.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 13.09.2021 përmes emailit zyrtar ka njoftuar stafin udhëheqës të ARC-së se: *.. siç diskutuan në ARC nuk ka staf esencial ,,1,“ familjet me fëmijë të regjistruar në institucionet parashkollore dhe me dy prindër të punësuar (ose që ka vetëm një prind dhe ai prind është i punësuar), njëri prind lirohet nga obligimi për t'u paraqitur fizikisht në punë gjatë periudhës 13-26 shtator 2021...”*. Ankuesja pas këtij njoftimi, dhe mbi bazën e Vendimit të Qeverisë, me datë 14.09.2021 paraqet kërkesë më shkrim të Udhëheqësi i saj për lirim nga paraqitja fizike në punë si dhe të personi përgjegjës ka dorëzuar Deklaratën për lirim nga puna me konfirmimin se ajo dhe bashkëshorti i saj janë të punësuar dhe se me mbylljen e kopshteve ankuesja duhet të kujdeset për vajzën e saj , ku si dëshmi ka ofruar edhe Kontratën e datës 03.09.2021 të lidhur me Qendrën Edukative “Bardha” par qëndrim ditor të fëmijës. Andaj, nisur nga ky konstatimet si Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses lidhur me mungesën e saj në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në rrethanat e vlerësuar si me lartë konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes se Vendimit me numër protokolli 751/03 të datës 19.10.2021, nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material respektivisht Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.


Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës,, Kolegji Bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.938/2021

Flakron GASHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Regjistrimit Civil;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

